



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. _____ Prot.

Tiranë, më _____.____.2024

VENDIM

Nr. 28, datë 24.01.2024

PËR

**NJË NDRYSHIM NË LISTËN E GJYQTARËVE UDHËHEQËS TË CAKTUAR ME
VENDIMIN E KËSHILLIT TË LARTË GJYQËSOR NR. 466, DATË 25.07.2023**

Këshilli i Lartë Gjyqësor, mbështetur në nenin 147/a të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, në nenet 61 dhe 97, pika 1, shkronja “b” të Ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, i ndryshuar, në nenet 14 dhe 33 të Ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, me propozim të Komisionit të Vlerësimit të Etikës dhe Veprimtarisë Profesionale,

VENDOSI:

1. Ndryshimin pjesërisht të listës së gjyqtarëve udhëheqës, të caktuar me vendimin e Këshillit të Lartë Gjyqësor nr. 466, datë 25.07.2023 gjatë praktikës profesionale të kandidatëve për magistratë të Shkollës së Magjistraturës, viti akademik 2023-2024, duke zëvendësuar gjyqtarin udhëheqës z. {...} me gjyqtarët:
 - i) znj. {...}, në cilësinë e gjyqtarës udhëheqëse të kandidatës për magistratë znj. Eda {...} sesionin e dytë 4-mujor (nëntor 2023 – shkurt 2024);
 - ii) z. {...}, në cilësinë e gjyqtarit udhëheqës të kandidatës për magistratë znj. {...}, për sesionin e tretë 4-mujor (mars – qershor 2024);
 - iii) z. {...} në cilësinë e gjyqtarit udhëheqës të kandidatës për magistratë znj. {...}, për sesionin e dytë 4-mujor (nëntor 2023 – shkurt 2024) dhe për kandidatin për magistratë z. {...}, për sesionin e tretë 4-mujor (mars – qershor 2024).
2. Ky vendim i njoftohet Shkollës së Magjistraturës, Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë dhe gjyqtarëve z. {...}, znj. {...}, z. {...} dhe z. {...}.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

PËR KËSHILLIN E LARTË GJYQËSOR